

Komuna e Mamushes

Data: 19.04.2019

Mbledhja e 01 e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi

Vendi: Mamushë

PROCESVERBAL

Mbledhja e 01 e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi është mbajtur me datë 19.04.2019 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Nga 13 anetarë në mbledhje kanë marrë pjesë 11 .

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi Z.Abdülhadi Krasniç.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi .

Të nderuar anëtar të Këshillit, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 01 Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

Rendi i dites:

- 1. Ligji për ndalimin e lojërave të fatit**
- 2. Gjendja e sigurisë në Mamushë(rreziku nga përmytjet e lumenjëve)**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Ligji për ndalimin e lojërave të fatit**

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

Ë përshëndes të gjithë, mirë se erdhët në mbledhjen e 01 të KKSB-së për vitin 2019. Sipas ligjit duhet të mbahen 6 mbledhje në vit, vitin e kaluar i kemi mbajtur dy mbledhje, pak ndoshta por më mirë pak se hiq. Komunitat e mëdha kanë probleme më të mëdha dhe janë të detyruara të mbajnë më shumë mbledhje. Pa humbur shumë kohë kalojmë në pikat e rendit të ditës. Para disa muajve Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të mbyllet bastoret, këtë qështje e kam vënë si pikë të rendit të ditës që ta shohim edhe ne si komunitet se qfarë mund të bëjmë. Qështja e dytë e cila ka të bëjë me gjendjen e sigurisë në Mamushë është rreziku nga përmytjet e ujit të lumenjëve. Vitin e kaluar lumenjtë kanë dalë nga shtretërit dhe kanë shkaktuar dëme të mëdha qytetarëve. Pika e tretë është të ndryshme ku në këtë pikë mund të diskutohen tema të ndryshme. A ka dikush diçka me shtu si pikë të rendit të ditës?

Rrahman Morina:

Qytetarët duhet të jenë më të kujdesshëm sa i përket zjarreve aktuale në Kosovë, nëse dikush don me ndez zjarr duhet të na lajmërojnë neve dhe na i orojmë siguri. Kemi pasur 68 ndërhyrje në Suharekë, 120 ndërhyrje në fshatra të ndryshme të komunës së Prizrenit.

Cafer Morina:

Këtë pikë duhet ta diskutojmë në të ndryshmet nëse ka nevojë e shtojmë si pikë të rendit të ditës në mbledhjet e ardhshme.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi)

Nëse nuk keni diçka për me shtu atëherë votojmë për rendin e ditës.

-Po (12)

-jo (0)

-Abstenim (0)

Me vota unanime rendi i ditës u pranua.

1. Ligji për ndalimin e lojërave të fatit

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Në kazinot pra vendet ku po luhen lojrat e fatit është vrarë një person, të nesërmen është vrarë edhe një person tjetër në Lipjan dhe si pasojë e kësaj Parlamenti i Kosovës ka organizuar mledhje të jashtëzakonshme dhe kapropozuar projekt ligjin për parandalimin e lojërave të fatit. Neve si komunë nuk ka ardhur asnjë shkresë. Sa i përket kazinove në Mamushë ne e shohim vetëm një që është përkaj rrugës kurse në fakt janë 4 casiono. Në qfarë gjendje janë ato nuk e dimë. Nëse ju si anëtarë të KKSB-së propozoni që ti mbyllni këto Cazino atëherë ne i mbyllim, e shikojmë ligjin dhe kompetencat që na takojnë neve me këtë ligj. A ka dikush diqka me shtu në lidhje me këtë pikë?

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Ju përshtendes të gjithë, fillimishtkisha dash të kyqem në këtë pikë për lojrat e fatit dhe cazinot që është miratu një ligj prej parlamentit të Kosovës. Në tërë Kosovën ka pas ndërhyrje nga njësite policore apo krimet ekonomike nga njësia e veqantë. Në Mamushë për fat të mirë cazinot dmth nuk kemi pa deri tash, kemi pa veq bastore. Fillim disa ditë ishin të mbyllur por me sa kemi informatë funksionojnë përsëri. Na veq jemi në kontakt me njësitin tonë dmth krimet ekonomike dhe ma merr menja që mbrenda disa dite edhe ktu do të kem ndalesë . Se që a duhet ta miratojmë na apo jo apo duhet ta përkrahim është diqka tjetër, është ligji që parlamenti e ka miratu dhe ajo duhet të respektohet. Ne jemi zbatues të ligjit dhe shumë shpejt ma merr menja që edhe ktu do të mbyllen gjitha lojërat e fatit. Ajo është e mirëseardhur për mendimin tim se ato vetëm mund ta dëmtojnë shoqërinë tonë sikur që kanë dëmtu deri sot kemi plot raste. Mendoj që mbrenda disa dite do ta kemi një aksion edhe ndaj këtyre bastoreve këtu dhe do të përfundojnë me veprimtarinë e tyre. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Ju si zyrtar policor na dhatë informata. Përderisa neve nuk na ka ardhë asnjë shkresë lidhur me parandalimin e lojërave të fatit unë desha me e marrë mendimin e juaj si anëtarë të komisionit dhe desha me ju informu që qeveria e Kosovës e ka shti në fuqi një ligj të tillë si dhe kemi menduar të ju informojmë se qka kemi bërë dhe qfarë duhet të bëjmë ne si komunë. A ka dikush diqka me shtu në lidhje me këtë qështje?

Rujdi Şala

Edhe feja e thotë që nëse diqka është e keqe dhe i shkakton dëme shoqërisë atëherë atë duhet me eliminu.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Ky ligj ashtu ashtu është miratu, por neve nuk na ka ardhur asnjë shkresë. Këtu ka qështje të përbashkëta që kanë të bëjnë me komunën dhe me policinë plus administrata tatimore e Kosovës. Së fundmi ne po jetojmë në Mamushë dhe e dijmë dhe disa familjeve iu kanë shkaktuar telashe, njerzve po u shpenzohen paratë, po shkaktohen përlëshje. Pra nuk është një punë e hajrit, është një punë që qytetarëve u sjell veq dëme. Nëse ne një vend bëhet në problem po ndikon në tërë lagjen dhe pasi që ne jemi të afërm në mes vete atëherë ede ne po ndikohemi.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Me rëndësi është që të përfundoj kjo, a është ligji mirë apo keq dikush tjetër e ka vendos. Te na në polici ska nevojë të vie asnjë shkresë, qdo gjë që është e kundërligjshme na do të veprojmë me të vërtetë në këtë drejtim.

Seylan Mazrek:

I përshëndes të gjithë . Këto casinot në Prizren janë hapur para 20-22 vjete dhe kur kam ndëgjuar që edhe në Mamushë janë hapur këso lloj lojra të fatit me të vërtetë shumë jam brengosur sepse në Prizren shumë njerëz kanë humbur gjithqka, edhe nëse është pak vonë pwr tu mbyllur prap se prap me mirë von se hiq. Unë jam shumë shumë e lumtur që po mbyllen këto casinot. Faleminderit.

Rujdi Kruezi:

Ju përshëndes të gjithëve. Me sa po e shoh këtu nuk ka shumëqka për tu folur, ligji veq se ka hy në fuqi dhe ne duhet ta respektojmë atë.

Cafer Morina:

Ju përshëndes të gjithëve. Siq e thatë edhe më herët kjo nuk është një gjë e mirë dhe familjeve përveq problemeve asgjë tjetër nuk u sjell, përleshje, humbje të paravë bile bile disa edhe florinjët i kanë shitur. Por pasi që ky ligj ka hy në fuqi ne duhet paraprkasht të jemi të pregaditur që nëse kemi të bëjmë me një qështje të tillë të dijme si të veprojmë.

Rrahman Morina:

I përshëndes të gjithë. Nëse një propozim i tillë ka kaluar në parlamentin e republikës së Kosovës neve na ka mbetur veq me zbatu. Të gjithë po e dinë si është gjendja sepse po i përcjellin nëpërmjet telvizioneve dhe radiove. Ne nuk kemi nevojë as me miratu sepse ku është e tërë Kosova edhe ne jemi aty.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Nëse nuk keni diqka tjetër me shtu në lidhje me këtë pikë atëherë ne kalojmë në pikën e dutë e cila është gjendja e sigurisë në Mamushë(rreziku nga përmytjet e lumenjëve)

2. Gjendja e sigurisë në Mamushë(rreziku nga përmytjet e lumenjëve)

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Nëse ju kujtohet vitin e kaluar në mledhjen që e kemi mbajtur poshtë e kemi parë dhe e kemi biseduar qështjen e dëmeve që i ka shkaktu shiu Mamushës dhe qytetarëve të Mamushës. Ne vitin e kaluar kemi biseduar që do të kalojmë në hartimin e projektit për zgjerimin e shtreterve të lumenjëve. Ne kemi hapur tenderin që lumenjët Tërja dhe Topllua të mirren mbrenda kufijve kadastral të Mamushës. Inxhinieri është duke e hartuar këtë projekt që në fakt ne si komunë nuk mund ta përballojmë një shumë të tillë. Mendimi dhe dëshira jonë është që nëse nuk mjafton buxheti ikomunës për projektin në fjalë të aplikojmë në MMPH për mbështetje. Vitin e kaluar Qeveria e Kosovës ka ndarë 400,000 € për kompenzimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut. Është bërë shpërndarja e këtij buxheti. A është ndarë në mënyrë transparente ky buxhet nuk e dimë por kryesorja Mamushës i ka ardh një ndihmë dhe kjo ndihmë nuk vjen qdo vit. Nese ne i lëjmë lumenjët në këtë gjendje e kemi rrezikun që për qdo vit të kemi

përmbytje pas qdo shiu. Shpresojmë që ta realizojmë këtë projekt. Komuna e suharëkës veq ka filluar ti pastroj lumenjtë e vet, i kanë hekur drunjët , mbeturinat që janë aty. E dini që 80 % e Mamushës mirret me bujqësi dhe nëse uji del nga shtrati i lumenjëve atëherë shkon huq e gjithë vera e bujqëve të Mamushës. Kjo nuk është një gjendje e mirë, disa qytetarë edhe duke e ditur disa edhe duke mos e ditur hyjnë në kufijtë e lumenjëve. Nëse ju kujtohet kur kemi qenë fëmijë lumi ka qenë i gjerë 20-30 metra ndërsa tani në disa vende është 1 metër sidimis lumi Tirnja është shumë keq.Kjo është gjendja e lumenjëve. A ka dikush diqka me shtu?

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Edhe unë desha me shtu diqka. Fillimisht ju thatë që skeni buxhet për ta ndërtu apo për ti mbrojtur qutarët nga vërshimet. Fillimisht duhet kadastro të del të vendos pikat dhe fillon punimet edhe komuna, ma merr menja që ju keni muni me një bager të rrafshoni, jo me ndërtu mur por investime tvogla sa për ta ndërtuar atë pjesë. Siq po shihet qdo vjet do të kemi problem me dëmtimin e pronave bujqësore, shtëpive të banimit apo diqka tjetër dhe për këtë arsye ju si komunë duhet të ndërmerrni ato veprime, fillimisht kadastro mandej em një firmë apo qysh shkon me tender e drejton sadopak , posaqërsiht kto vendet ku janë ma rrezik mandej me projektet e juja kërkon nga Ministria tju përkrah në këtë drejtim. Fillimisht hapi parë duhet kadastro te vendos ato pikat se ka lëviz lumi edhe prona e kujt është. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për siguri në bashkësi

Vitin e kaluar e kemi përjetuar të gjithë. Nafaka më e madhe ka qenë që ka qenë fundi i sezonës, po të kishte qenë fillimi i sezonit shumë keq sepse njerëzit kan hy borxh 5,000-10,000€ për fara, për najllon.Edhe nesër me ra naj shi këto lumenjë me këto ngushtica prap do të shkaktojnë probleme.

Rujdi Kruezi:

Një herë u pastru lumi dhe u bë shumë mirë, nuk shkaktohej asnjë problem edhe kur binte shi por disa njerëz ka që kanë hy edhe ne kufijtë e lumit.

Albiyona Sadiku:

Por edhe nëse merret vendim që të bëhen matjet e pronave apo kufijve duhet të jenë pronarët aty me pa niherë e pergjithmon e kujt është.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi

Normal krejt pe dijnë se ku asht kufini por është diqka tjetër që spo e pranon se pi konvenon,kajta.

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Mamusha është e vogël edhe nëse ju vet nuk keni të afermit e ju j kanë nga një tokë edhe të garantoj që qdo njani ka me pas problem e para. E dyta është problemi ipronave këto që nuk janë shpronësu, legalizimi nuk është bë, ndërtimi, urbanizmi është katastrof. Këto janë krejt qështje të komunës. Duhet me ja nis dyqysh, pronari a e din ku e ka, nëse e ka 10 ari aj sun e ban 20 ari at vend sado le ta ozurpon. Edhe mu pom konvenon me pas rrogën 5,000€ po qaq e kam. Për këtë arsye duhet të gjithë së bashku të veprojmë në këtë drejtim, se shumica e rasteve kërkojnë prej policisë ndihmë, ok na jemi për më ndihmu, ose bërllugin e gjujn kërkojnë prej policisë ndihmë, ose aksidentet po ndodhin policia kërkon që ti dënojnë, ok na i shqiptojmë dënimet edhe shumë i shqiptojmë por nuk luftohet qdo gjë veq me polici.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi

Na si komunitet ende spo mujm me kuptu diqka që kjo është komuna, komuna sështë vetëm për me dhon, jepi bane kocka bane asfalt por komuna ka edhe për me marrë psh po du me bo unë ni shpi duhet me marr ni leje, duhet me qenë ni projekt, leje urbanistike. Duhet ta paguajë taksën, mbeturinën. Duhet me i msu qytetarët me ju përshtat këtyre kushteve.

Rujdi Krëezi:

Në fillim ndoshta është vëshirë por mësohen.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi

A ka dikush diqka me shtu në lidhje me rend te ditës. Unë desha veq me ju informu se qka mund të bëjmë ne si komunë edhe qka duhet të bëjmë si qytetare, në fakty ne e dimë të gjithë se qka duhet të bëjmë por po na vjen zor apo duhet të shpenzojmë para atëherë ligji na vënë në binare të gjithëve. Nëse nuk keni diqka tjetër me shtu atëherë alojmë në të ndryshmet.

3.Të ndryshme

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi

Sa i përket të ndryshmeve unë desha të flas pak për mbeturinat që po i hudhin në qdo aqnë të rrugëve, poi hudhun edhe në lum. Ne javën e kaluar kemi pastruar mbeturinat që gjenden në rrugen per fshatin Retije edhe ne rrugen qe të shpie tek Hotel Lika . Ne kemi diqka që e kemi planifikuar si komunë, është një pronë pas zjarrfikësve, disa potoqe, gropa. Janë 1 hektar e 80 ari që po dalin në emër të komunës dhe aty kemi menduar ti deponojmë së paku mbeturinat e ngurta që po i prishin shtëpitë si zalli, tjegullat. Aty duhet të bëhen disa punime per ta hapur rrugën deri atje. Mbeturinat ushqimore ashtu ashtu po i mledh një firmë. Pas kësaj nëse dikush e hedh ndonjë mbeturinë diku këtë herë do të fillojmë me ndëshkime sepse nuk kemi zgjidhje tjetër. Pa i prekur në gjep nuk ndalen së hedhuri. Ne si qytetare krahasuar me komunat tjera jemi shumë të pa pastër për sa i përket mbeturinave. Kjo është qështja e mbeturinave ndërsa sa i përket zjarreve.

Rrahman Morina:

Sipas raportit te muajit Mars 01.03.2019 kemi pasë 112 ndërhyrje në Prizren, 79 ndërhyrje në suharekë, 63 ndërhyrje në Rahovec, 32 ndërhyrje në Mamushë, Mamusha komunë e vogël por ka pas 32 ndërhyrje. Me këto 32 dalje 5 shërbime i ka bërë në Prizren, 3 shërbime në suharekë si ne fshatrat gurri dellovcit, duhël dhe stundenqan. Kemi pas edhe nje takim me prokurorin ku edhe i kemi shkëmbyer numrat e telefonit dhe kanë kërkuar që ti lajmërojmë për personat që i shohim duke i ndezur zjarret dhe do ti ndenojmë por unë nuk kam parë ndonjë dënim të tillë as nga komuna e jonë as nga komuna e prizrenit apo Suharekës, sepse në raporte prap po e shkruajmë për shkaqe të panjohura ka pasur zjarr. Në rregull shmbull drejtori mundet me has në një zjarr dhe mundet me e lajmëru Rrahmanin, por njeriu po shkon po i hudh mbeturinat po i ndez pastaj po ndizen edhe bagremat dhe gjithqka qka ka aty. Në rregull nëse don me e djeg thirrëm mua sepse unë për këtë po paguhem, por nëse është e nevojshme edhe le te dënohen, 1 dënim i vetëm në Mamushë iu është shqiptuar Muharrem Xhemali Kovaçit dhe ai është njeriu më i urtë në Mamushë. Nëse në Mars dalin qekaq zjarre paramendoni sa do dalin në muajin gusht? Në vitin 2015 kemi organizuar seminar për nxënësit e shkollës fillore Anadolu dhe pas këtij seminari janë reduktu zjarret në 70%. Ne nuk po ndërhyjmë vetëm në zjarre por edhe në kanalizime, pastrimin e oborreve dhe unë po e

bëjë këtë punë me kënaqësi sepse jam banor i Mamushës dhe jam i detyruar të shërbejë këtu. Këto janë të gjitha që pata me i thënë unë. A keni diqka me pyt?

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Qdo vjet kemi telashe këto mujt e para në tërësi të Kosovës vjen deri te zjarri se vet qytetarët e ndezin atë , përveq që e rrezikon jetën e qytetarëve, shtazëve ti e rrezikon edhe ndotjen e ambientit se na e dim nga statistikat vjetore që i bojnë se qfarë ndotje e ambientit është në Kosovë. Na duhet ti msojmë se ajo nuk djeget por pastrohet por na për mos me punu punë fizike hajt pe kallim. Po sun pe fut ma në kontroll kur pe djeg. Na kemi disa tiketa për komunikacion ngajshëm me të do ta kemi edhe tiketat për kundërvajtës të tjerë, hedhja e bërlllogit, hedhja e bërlllogin në lum. Sipas ligjit të ri na është dhënë urdhër deri në 500€ të shqiptohet dënim. Përpara kemi dërguar mbi 50 euro kundërvajtje ndërsa tani mbi 500 euro nëse asht masa sanksionuese me dënim atëherë dërgojmë në gjykatë. Deri 500 Euro nuk e dërgojmë, du javë ditë 15 ditë na e kemi atë në polici, e fusim në sistemin tonë edhe në kundërvajtje edhe në komunikacion, mas 15 dite nëse se pagun e pagun totalin e asaj sa asht por mbi 15 dite mo nuk asht problemi i policisë simbas ligjit të ri, kto e kthejmë na në komunë se të gjitha dënimet që ndëshkohen në një komunë të hollat shkojnë në buxhetin e komuës. Por nuk jemi veq na që do të merremi me këto qështje se inspektorët komunal janë zryrtarët kryesor që mirren me qështjet si ndërtim, bërlllog, zjarr, infrastrukturë, legalizim, shfrytëzim i hapësirës publike, pa lejen e komunës, qdo hapësirë që shfrytëzohet me lejen e komunës shteti përfiton prej tatimeve.

Albijona Sadiku:

Sa i përket denimeve, kur dikush ka me u dënu duhet me e qu deri në fund procedurën, e jo bash kur po bahet me e dënu po del dikush aty qe pe fal edhe u kry, prap njëjt po vazhdon se dënimi nuk po shkon deri në fund. Nëse e paguj une 100 € se kum bo diqka une mo nuk e baj se e di që prap kan mem prit ato 100 € edhe nëse ai është i gatshëm që qdo muj me i jap ka 100 € për të njëjtin sen ma merr menja që se ban mo. Se unë po shoh shumë fmi që nuk po shihen, kam me tu kput tu menu që po hec kerri vet, ku e sheh aj këmbësorin kur aj nuk e sheh vllanin mire.

Ganimete Sadiku:

Njo me kombi të bardhë kërrsh u kon tu i bo fmijen te shkolla, fmija i vogël që po thot albiona spo shihet hiq i ka hyp edhe njo 3 tjer aty edhe po sillet ka shkolla. E kum fotografu

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

A i ke pa, a ma ki nr e telefonit, thirri vjen patrulla meniher. Aty dëshkohet prindi, nuk ndëshkon fmija se fmija nën moshën 14 vjet nuk ndëshkohet absolut.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

A ka dikush diqka tjetër me shtu rreth të ndryshmeve?

Enis Orqusha(Komandant i Stacionit Policor)

Pyetja e kamerave, kemi pas disa raste të vjedhjeve që për fat të keq është zbuluar por neve na nevoitet dëshmi . Të kishim pas kamera unë garantoj 99% se kryerësit e veprave penale ishin zbulu për fat të keq me qytetarë jemi larg bashkëpunimit. Kamerat janë qe 1 vjet e mbi 1 vjet që nuk janë funksional, i kemi pas na kamerat, të gjitha kanë qenë funksional përveq prje ditës së parë qysh kam thon 5-6 kamera nuk

kanë funksionu 18-19 kanë qenë funksional, sot asnjë nuk funksionon që na pengon për të parë rastet . Unë nashta di Rrahmani, Hyseni e ka kry veprën ama përderisa ska dëshmi smujm me bo asgjë . Tjetra, nga komuna kërkoj shenjat, vijat e komunikacionit të vendosen, asnjë vendkalim për këmbësorë nuk ki në Mamushë, asni vit të plotë apo me vija të ndërprera , ndonjë pengesë para shkollav posaqërisht. Kena fol sdi sa herë por asgjë nuk po ndërmirren.Vijat, shenjat, parkingjet . unë sun veproj në disa gjëra përderisa nuk është e kufizuar me shenja të komunikacionit. Pika tjetër sa i përket shkollave, unë kisha preferu dera hyrëse e shkollës fillore është ktastrof, direkt ng dera e oborrit të shkollës fëmija e qet kembn drejt në rrugë. Ajo derë le të mbyllet dhe hyrja të jetë ose anash ose nga pjesa mrapa diku, por mos të ketë direkt fmija qasje në rrugë. Edhe pika tjetër te kabllat elektrike, postës, internetit e të gjitha tjerat janë tepër të ulëta dhe qdo herë na shkakton pengesë edhe problem , e dini që mamusha është vend që mirret me tregti edhe ka shumë kamiona të mdhaj. Shumicën e rasteve kemi probleme që kamioni ose e kput kabllën ose shkakton ndonjë problem tjetër. Ato janë jashtë standardeve. Një kabëll elektrike sipas standardeve duhet të jet mbi 4.25 e lartë, nëse është nër këtë gjatësi atëherë përgjegjëse është kompania që i ka instalu kabllat .

Alobijona Sadiku:

Sa i përket KEDS-it edhe na e kem bash te shpija ka nashta 5-6 vjet një shtyllë elektrike që asht gati yu u rrxu, edhe që 7 vjet ren asht gjyshi tu shku tu lajmëru në mmushë, në Prizren, në Prishtinë, kërkush svjen as me kqyr bile se jo me marrë masa kundër saj.

Abdülhadi Krasniç. Kryesuesi i Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi.

Të nderuar pjesmarrës në mledhjen e ardhshme nëse keni ndonjë kërkesë nga ju mundemi me ia bashkangjit. Mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
İdriz Mazrek

Kryesuesi i KKSB-së
Abdülhadi Krasniç
